

20080841558

L I G J
PËR HYRJEN NË BORXH TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA
NDËRKOMBËTARE PËR NDËRTIM DHE ZHVILLIM - BANKA
NDËRKOMBËTARE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA TË PROJEKTIT PËR
PËRMIRËSIMIN E RRJETIT EKZISTUES RRUGOR RAJONAL DHE LOKAL

Neni 1

Republika e Maqedonisë hyn në borxh te Banka Ndërkombëtare për Ndërtim dhe Zhvillim-Banka Ndërkombëtare me hua në shumë prej 70.000.000 euro, të dedikuar për realizimin e Projektit për përmirësimin e rrjetit ekzistues rrugor rajonal dhe lokal.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga paragrafi 1 i këtij neni, përcaktohen me Marrëveshjen për hua për Projektin për përmirësimin e rrjetit ekzistues rrugor rajonal dhe lokal, e cila do të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Ndërtim dhe Zhvillim- Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Afati për pagesën e huas nga paragrafi 1 i këtij neni është 20 vjet, me periudhë grejs të përfshirë prej pesë vjetësh. Shkalla e kamatës sipas së cilës do të servisohej huaja është LIBOR (për valutë euro) plus diferenca variabile. Shkalla e kamatës mund të zvogëlohet në bazë të marrjes së vendimit paraprak të Bankës Ndërkombëtare për Ndërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore. Huaja do të fillojë të paguhet në 30 këste gjysmëvjetore, në çdo 15 mars dhe 15 shtator të vitit. Nga 15 shtatori i vitit 2013 deri më 15 shtator të vitit 2027 do të paguhet 29 këste gjysmëvjetore, secila në shumë prej 3,33% të huas, gjegjësisht 2.331.000 euro, derisa më 15 mars të vitit 2008 do të paguhet kësti në shumë prej 3.43% të huas, gjegjësisht 2.401.000 euro.

Në grejs periudhën prej pesë vjetësh, e cila paraqet edhe periudhën e realizimit të projektit, do të paguhet vetëm kamata e huas.

Në ditën e tërheqjes së mjeteve, Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Botërore provizion të njëhershëm në shumë prej 0,25% të shumës së huas.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji është Fondi për rrugë magjistrale dhe rajonale.

Neni 5

Republika e Maqedonisë, huan nga neni 1 i këtij ligji do ta servisojë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".